

**VENDIM**  
**Nr. 98, datë 17.2.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E  
PËRGATITJES SË SHESHEVE TË NDËRTIMIT, NË BASHKINË DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 55 098 000 (pesëdhjetë e pesë milionë e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekësh pa TVSH, për financimin e sistemit të territorit, lirim të sheshit dhe kthimin e sipërfaqes në kuotë për ndërtimin e 44 (dyzet e katër) njësive individuale të banimit në Njësinë Administrative Ishëm, Bashkia Durrës.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**